



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE

Nr. 512/1 Prot.

Tiranë, më 09.06.2015

VENDIM

“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 37, datë 09/06/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesja/znj. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr.512 Prot., datë 27.05.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Zyra qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Pa Luajtshme) si dhe ndaj Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Pa Luajtshme, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, znj.

në datë 27.01.2015 dhe në datë 17.03.2015, ka paraqitur pranë Autoritetit Publik/ZQRPP, kërkesat për informacion. Kërkesja ka kërkuar ti vihen në dispozicion kopje të dokumenteve, konkretisht, rimbursimin e shumës 2000 lekë, për aplikim të gabuar si dhe informacion/dokumentacion në lidhje me tarifën e aplikuar.

Ankuesja pretendon se është cenuar në të drejtën e saj për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar megjithëse ka kaluar afati ligjor. Për këtë arsye ka depozituar ankim në zyrën e Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri ka konstatuar se, ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor, në kundërshtim me gërmën “b”, të pikës 2, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas të cilit “*ankimi administrativ pranë Komisionerit për të drejtën e infomimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale bëhet brenda 30 ditë pune nga dita kur ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënie informacioni.*”

Komisioneri vlerëson se ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

VENDOSA:

1. Rrëzimin e ankesës nr.512 Prot., datë 27.05.2015 të Znj. , kundër Autoritetit Publik/ ZQRPP (Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Pa Luajtshme) dhe kundër ZVRPP (Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Pa Luajtshme).
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 09.06.2015.

